

UDHËZIM
Nr. 296, datë 18.6.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 481, DATË 27.6.2019, “PËR PROCEDURAT
E PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 481, datë 27.6.2019, “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime:

1. Pas germës “g”, pika 4, kreu 2, shtohet germa “h”, me këtë përmbajtje:

“h) Komisioni i Vlerësimit monitoron procesin e përzgjedhjes së vendeve të lira të punës, më specifikisht: njoftimin, ofrimin dhe përzgjedhjen e vendeve vakante për profesionistët e shkencave mjekësore teknike.”.

2. Shkronja “a”, paragrafi i parë, kreu 3, shtohet dhe bëhet:

“a) Vlerësimin e dosjes së kandidatëve që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë. Brenda numrit total prej 30 pikësh shtohet bonus si më poshtë:

- studenteve të ekselencës 10 pikë,

- profesionistëve të shkencave mjekësore teknike, që kanë punuar për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve të prekur nga COVID-19, në spitalet kovid 1, 2, 3 dhe 4 (të vërtetuar me shkrim nga DROSHKSH Tiranë) për një periudhë mbi tre muaj, 5 pikë.”.

3. Pika 3, kreu 4, ndryshohet dhe bëhet:

“3. Për vendet e lira të punës për çdo NJVKSH, kandidati njoftohet nga Komisioni i Vlerësimit të DROSHKSH-së përkatëse, në varësinë e së cilës është vendi vakant, përmes postës elektronike, mesazhit në celular dhe telefonatave në adresat të cilat kandidati i ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe në dosje.”.

4. Në pikën 4, kreu 4, togfjalëshi “DROSHKSH” zëvendësohet me togfjalëshin “Komisioni i Vlerësimit”.

5. Pika 9, kreu 4, ndryshohet dhe bëhet:

“9. Në rast se do të ketë vende të lira pune, të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët fitues në listën e pritjes për atë njësi, këto pozicione mund të plotësohen përkohësisht, vetëm atëherë kur është e mundur lista e fituesve sipas qarkut përkatës. Pozicioni i lirë mund të plotësohet nga kandidatë të licencuar në profilin përkatës deri në punësimin e kandidatit fitues nga portali. Në këto raste, NJVKSH-ja i drejtohet me kërkesë DROSHKSH-së, e cila pas një vlerësimi e përcjell kërkesën për miratim emërimi të përkohshëm pranë DQOSHKSH-së.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu